

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 3 SHKURT 2022

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Sot diskutohet për votimin e një marrëveshjeje me fqinjin tonë jugor për luftën kundër krimit të organizuar. Me këtë rast dua të theksoj se çdo marrëveshje e kësaj narkoqeverie për luftën kundër krimit të organizuar është fund e krye një falsitet, një formalitet, pasi Shqipëria është vendi ku krimi i organizuar, siç thotë raporti i DASH-it, e ka shndërruar në qendrën operacionale të organizatave kriminale të rajonit, Europës, Amerikës së Veriut, Amerikës së Jugut dhe Lindjes së Mesme. Nuk ekziston një vend i dytë me këtë fuqi të së keqes së krimit si Shqipëria dhe kjo ka vetëm një arsye, lidhjen e tij të tmerrshme me qeverinë. Narkoqeveria e kreut të “Meduzës” e nisi qeverisjen e saj me instalimin në Xibrakë të uzinës më të madhe të kokainës në Ballkan, nën patronazhimin direkt të klanit “Rama”. Ringlidi i Hakmarrjes për Drejtësi për furnizimin me kokainë ishte Genti Xhixha, lidhje direkte e Edi Ramës dhe Olsi Ramës. Ky është vetëm njëri shembull. Vazhdojmë më tej. A nuk u faktua këtu lidhja direkte e ministrit të Brendshëm dhe e pasardhësit të tij me klanet e drogës? A nuk ishin këto të qarta si drita e diellit? A nuk u vodhën në kasafortën më sekrete të shtetit, në Ministrinë e Brendshme, dosjet e 29 kriminelëve? Me urdhër të Edvin Ramës përgjegjësi i këtij veprimi u rikthye tani në një detyrë shumë të rëndësishme në Ministrinë e Brendshme.

Kush e ka harruar operacionin “Viluni”, kur pesë polici të vendeve përreth u angazhuan në çmontimin e një rrjeti kriminal dhe se si ishdeputeti Mark Frroku nxori liderin e grupit të trafikantëve, natyrisht kryekëput me lejen dhe urdhrin e Edi Ramës? Çfarë po ndodh tani? Për këtë foli këtu edhe një parafolës. Kompanitë e bananeve janë tre-katërfishuar brenda disa muajve. A e dini pse? A e dini ju kush e kontrollon Portin e Durrësit? Nallbati i Xibrakës, Nallbati i Hakmarrjes për Drejtësi, Nallbati i Edvin drogës e Lulzim “Pengut”, që e ka gjysmë baxhanak të dashur. Nuk është rastësi që kokaina është kaluar te porti i Durrësit. A e morët vesh ju, zotërinj, që Emar-i u zhduk? Emar-i s’ka më lidhje me portin e Durrësit, por kanë dalë disa kompani shqiptare offshore, me në krye kreun e “Meduzës” dhe natyrisht në bashkëpunim me Lul “bravën”, që do pastrojnë aty shuma përrallore parash, 2 miliardë euro në 800 mijë metër katrorë. Unë po ju them, dhe do t’ju njoftoj edhe në seancat e tjera, se afera e portit të Durrësit është më e madhja korruptive në Europë. Kjo që po them unë sot këtu është vetëm njëri kapitull, kapitulli tjetër është edhe më i zi. Fqinjët tanë e kanë shqetësim të madh krimin në Shqipëri. Prokurori italian deklaroi dje se mafia shqiptare, mafia e klanit “Rama” (shtesë e imja), sot është më e rrezikshme sesa Ndragheta.

Ju jeni dëshmitarë se si filloi bashkëpunimi. Ju jeni dëshmitarë se si Edi Rama me Lal “plehun” futën kompanitë e mafies te plehrat, por kjo shkoi duke u rritur në progresion gjeometrik dhe sot, sipas autoritetit numër një në Europë për vlerësimin e mafies, që është Prokuroria e Antimafies në Itali, e tejkaloi Ndraghetën. Policia shqiptare është e kanabizuar në çdo qelizë të saj. Një javë më parë pashë një qytetar teksa i thoshte policit: “Ajo kapelja të kushton 350 euro të taksave të mia, në një kohë kur në Suedi kushton 15 euro”. Se këta, si lukuni, përdorin krimin dhe vjedhjen! Është një polici jo vetëm e kanabizuar, por edhe e ideologjizuar. A e dini se çfarë ndodhi dje, apo jo? Drejtori i Policisë, në pamje të parë, një i ri duket, unë nuk ia di moshën, por me porosi të këtij këtu, të ministrit të familjes dhe të bosit të tij, i dërgon një telegram të gjatë, një mesazh të gjatë ngushëllimi njërit prej xhelatëve më të egër të shqiptarëve, ish-drejtorit të policisë hoxhiste për 15 vjet. Ju duhet ta dini. Ata që janë të rinj, duhet ta dinë se gjatë diktaturës policia politike e Enver Hoxhës dhe Policia e Shtetit bënin garë se cila

do të zbulonte më shumë armiq të popullit dhe armiq të klasës, se cila do të çonte më shumë në pranga në përmbushjen e detyrave si armë e partisë, se cila do të internonte më shumë. Pra, Policia e Shtetit nuk ishte Sigurimi i Shtetit, por ishte një armë me definicion, siç ishte edhe ushtria, në duart e paradiktaturës së proletariatit, në duart e Partisë. Dhe, urdhëroni, i dërgon mesazh vlerësimi, me fjalët, me superlativa një xhelati të shqiptarëve, një xhelati të vërtetë të shqiptarëve! Dhe ju prisni pastaj të luftohet krimi! Krimi më i shëmtuar, më i egër, më barbar, më i pamëshirë, është i kriminelëve në qeverinë shqiptare dhe bashkëpunëtore të tyre kudo janë!